



A

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	5A-02
Nr. i Faqeve Br. Stranica	-03-
Nr. i Prot. Prot. No.	6856-2/25
Data Datum	05.02.26
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.01.2026
REFERENC-Ë:	25/6657/559/DMM
PËR/ZA/TO:	"Art Minerals" L.L.C. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 25/6657/559/DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Refuzim** të kërkesës së Kompanisë "Art Minerals" L.L.C. Gjakovë për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore në parcelën P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-019498-0 në Z.K. Pjetërshtan, Komuna e Gjakovës.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzim i kërkesës së Kompanisë "Art Minerals" L.L.C. Gjakovë për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore në parcelën P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-019498-0 në Z.K. Pjetërshitan, Komuna e Gjakovës.


A r s y e t i m

Komisioni për VNM ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të Kompanisë "Art Minerals" L.L.C. Gjakovë, dhe gjatë shqyrtimit të Kërkesës, raportit të VNM-së si dhe dokumenteve përcjellëse të Kompanisë është konstatuar se dokumentacioni ka qenë i kompletuar.

Komisioni, me datën 22.09.2025 e ka njoftuar OE për organizimin e debatit publik, dhe me datën 25.09.2025 ka bërë konfirmimin për mbajtjen e debatit publik.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, është mbajtur debati publik me datën 12.11.2025. Në debat kanë marrë pjesë hartuesi i Raportit, përfaqësuesi i Kompanisë dhe banorët nga Dolci dhe Kusari si dhe zyrtari i MMPHI-së përmes platformës elektronike.

Faqe 2 nga 3



Në debat publik projekti është kundërshtuar nga banorët e fshatërave duke pretenduar se zona në fjalë është e mbrojtur sepse ajo zonë është zonë arkeologjike dhe në të gjinden artifaktet.

Gjithashtu me datën 27.09.2025 Komisioni ka pranuar nga zyrtarja e lartë për planifikim urban të Komunës së Gjakovës, z. Rozafat Hoxha, emailin në të cilën argumenton se parcela në fjalë shtrihet zonës së mbrojtur të aseteve të trashëgimisë arkeologjike bazuar në raportin e lëshuar nga Instituti Arkeologjik i Kosovës për lokalitetin Arkeologjik "Fortifikimi i Antikvitetit të Vonë në Kusar". Gjithashtu zyrtari emailit ia ka bashkangjitur edhe Raportin nga Vizita në asetin e trashëgimisë arkeologjike "Fortifikimi i Antikvitetit të Vonë në Kusar" të protokolura nga IAK me nr. prot. 632/2025, të datës 25.11.2025.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr **Vendim për Refuzim** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Art Minerals" L.L.C. Gjakovë, për shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore në parcelën P-70705057-01948-0 dhe P-70705057-019498-0 në Z.K. Pjetërshtan, Komuna e Gjakovës.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/6816/ - ZSP/ /26 datë: 19.01.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. AMMK-së
4. Inspektoratit
5. Komunës së Fushë Kosovës
6. Kabinetit të Ministrit
7. Divizioni për Leje dhe Licenca Mjedisore
7. Divizioni për Komunikim me Publikun
8. Arkivit të MMPHI



Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI